



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.55

10 maj

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 29.4.2010	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2009 2079
Rezolutë e Kuvendit datë 29.4.2010	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit Drejtues të RTSH- së për vitin 2009 2079
Rezolutë e Kuvendit datë 29.4.2010	Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për vitin 2009 2080
Dekret nr.6525 datë 29.4.2010	Për lejim lënieje të shtetësisë shqiptare 2081
Vendim i KM nr.274, datë 13.4.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar 2082
Vendim i KM nr.299, datë 3.5.2010	Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin, vlerësimin dhe rivlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut dhe përmbytjet e kohëve të fundit në qarkun e Shkodrës 2102
Udhëzim i MD nr.3922, datë 28.4.2010	Për mënyrën dhe procedurën e regjistrimit të dënimeve të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë nga autoritetet gjyqësore të huaja 2105
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Theodhor Anastas Paparusi 2107

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR VITIN 2009

Kuvendi i Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit dhe me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi u njoh me raportin vjetor të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2009, vëren se:

- Veprimtaria e KKRT-së është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

- KKRT-ja ka arritur të dukshme në zbatimin e kërkesave të Kuvendit të Shqipërisë.

Kuvendi vlerëson se:

- KKRT-ja gjatë vitit 2009 ka bërë përpjekje maksimale për të rritur efikasitetin e punës së saj, duke kontribuar në ngritjen e cilësisë së shërbimit të radios dhe televizionit dhe në mbrojtjen e interesave të operatorëve dhe konsumatorëve.

- KKRT-ja ka ushtruar kontrolle të vazhdueshme dhe ka vendosur sanksione ndaj shkelësve të ligjit, duke rritur në këtë mënyrë garancitë për një konkurrencë të ndershme.

- KKRT-ja ka hartuar projektstrategjinë e kalimit nga sistemi analog në atë numerik.

Kuvendi kërkon nga KKRT-ja:

- Marrjen e masave për kalimin sa më shpejt në transmetimet numerike brenda afatit të përcaktuar nga Qeveria.

- Rritjen e efikasitetit ndaj luftës kundër piraterisë televizive.

- Zbatimin me rigorozitet të ligjit ndaj operatorëve që transmetojnë programe të propagandës së diktaturës komuniste.

- Zbatimin e etikës në transmetimet televizive, respektimin e barazisë gjinore dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

- Realizimin e shpenzimeve të planifikuara.

- Të ushtrojë ndikimin e saj tek operatorët radiotelevizivë për realizimin e programeve të veçanta për emigrantët, sidomos për mësimin e gjuhës shqipe dhe promovimin e trashëgimisë historiko-kulturore.

- Të marrë pjesë aktive në diskutimin e projektligjit të ri “Për transmetimet me zë dhe figurë në Republikën e Shqipërisë”.

Kuvendi nxit:

- Bashkëpunimin e efektshëm të organeve të tjera shtetërore, si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, për të siguruar zbatimin e ligjit.

29 prill 2010

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH-SË PËR VITIN 2009

Kuvendi i Shqipërisë vëren se:

- Këshilli Drejtues i RTSH-së ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur imazhin e RTSH-së, si një institucion serioz publik kombëtar, siç e përcakton ligji.

- RTSH-ja, sidomos gjatë vitit 2009 e në vazhdim, po punon intensivisht për përmirësimin e parametrave cilësorë në shërbim të telespektatorëve.

- Këshilli Drejtues dhe titullarët e RTSH-së janë përpjekur për të realizuar rinovimin e teknologjisë dhe dixhitalizimin, me qëllim që RTSH-ja të jetë konkurrenti kryesor në tregun mediatik, por akoma nuk ka mundur të plotësojë këtë objektiv shumë të rëndësishëm.

- Kërkohet një mbështetje akoma më e madhe nga Buxheti i Shtetit për përmirësimin e teknologjisë radiotelevizive dhe kualifikimin teknik e profesional të personelit të RTSH-së.

- Kërkohej rishikimi i kuadrit ligjor për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë së këtij institucioni.

Kuvendi vlerëson se:

- Janë bërë përpjekje serioze për përmirësimin e strukturës programore të RTSH-së, duke fituar terren në tregun mediatik, duke nxitur ndjeshëm format sa më gjithëpërfshirëse të dialogimit qytetar, gjë që ka mundësuar rritjen numerike të dëgjuesit dhe teleshikuesit publik ndaj këtij operatori.

- Risi për këtë vit janë, sidomos, futja e edicionit të lajmeve në anglisht dhe të edicionit informativ për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara shqisore.

- Në programet e RTSH-së janë bërë përpjekje në drejtim të rritjes së pavarësisë editoriale.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 470, datë 29.9.1993 “Për kalimin në inventar të pushtetit lokal të godinave, aparaturave dhe linjave të pikave përsëritëse” ka penguar mirëmbajtjen dhe ruajtjen e këtyre pajisjeve, për shkak të paqartësive dhe dublimeve të kompetencave ndërmjet pushtetit vendor apo Këshillit Drejtues të RTSH-së.

Për sa më sipër, Kuvendi kërkon nga Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të RTSH-së:

- Në zbatim të nenit 88 pika 6 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, hedhjen e shortit për përcaktimin e mandateve të anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së.

- Të bëjnë propozimet konkrete, në lidhje me projektligjin “Për transmetimet me zë e figurë në Republikën e Shqipërisë”, duke marrë në konsideratë dhe sugjerimet e Komisionit Europian dhe të Këshillit të Europës.

- Me qëllim që të realizohet përmirësimi teknologjik i infrastrukturës teknike të RTSH-së dhe kualifikimi profesional i punonjësve, në mbështetje të nenit 115 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Drejtues dhe Drejtoria e Përgjithshme e Radiotelevizionit Shqiptar të rrisin rendimentin e punës së strukturave të RTSH-së për rritjen e buxhetit të këtij institucioni mjaft të rëndësishëm, duke siguruar fondet financiare jo vetëm nga Buxheti i Shtetit, taksa mbi aparatin marrës, por edhe nga kontratat me palët e treta për transmetime të ndryshme, shërbime të tjera programesh, botimet e prodhimeve muzikore, video, audio, librave, gazetave, revistave që lidhen me programet etj.

- Të përgatisin personelin teknik, nëpërmjet trajnimeve profesionale dhe rekrutimit të njerëzve të rinj të aftë, që i përgjigjen stadit të teknologjisë moderne.

29 prill 2010

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE PËR VITIN 2009

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke konsideruar luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave si një nga sfidat kryesore dhe prioritet e kësaj mazhorance;

- Duke riafirmuar rolin e pazëvendësueshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive në zbulimin, evidentimin, dhe parandalimin e konfliktit të interesave dhe praktikave të pasurimit korruptiv;

- Duke vlerësuar arritjet dhe rezultatet efektive të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive në parandalimin e zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesave dhe në zbulimin e fshehjes së pasurisë për vitin 2009;

- Me objektivin që lufta kundër korrupsionit të sjellë rezultate të qarta, të forta e të pakthyeshme, në stabilizimin e plotë të kulturës qeverisëse antikorruptive,

Konstaton për vitin 2009 se ILDKP-ja:

- Ka ushtruar me vendosmëri kompetencat e tij ligjore për dhënien e masave administrative dhe dërgimin e çështjeve në organin e akuzës, në zbatim të ligjit, për zyrtarët që kanë refuzuar deklarin e interesave privatë, kanë fshehur pasurinë apo kanë bërë deklarin të rremë, si dhe për shkelje të ligjit të parandalimit të konfliktit të interesave;

- Ka dëshmuar një vullnet të mirë dhe është bërë nismëtar për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me struktura të specializuara e përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit e krimit ekonomik, brenda dhe jashtë vendit;

- Ka vazhduar trajnimin me subjektet e parashikuara në ligj, në lidhje me zgjidhjen e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive, duke synuar në këtë mënyrë rritjen e performancës së zyrtarëve të administratës në institucionet qendrore dhe vendore.

Për vitin 2010 kërkon:

- ILDKP-ja të vijojë forcimin e kapaciteteve për administrimin e konfliktit të interesave në institucionet publike;

- Të propozojë ndryshimet e nevojshme në legjislacion për rregullimin e pasojave juridike të shkaktuara nga situatat me konflikt interesi dhe për ndëshkimin e zyrtarëve apo personave të lidhur me ta, përgjegjës për konfliktin e interesit;

- Të forcojë marrëdhëniet publike e të promovojë veprimtarinë e vet, me qëllim sensibilizimin dhe edukimin nëpërmjet shembujve të veprimit të ligjit, si dhe për të rritur besimin e publikut në efikasitetin e mekanizmave të vet antikorrupsivë;

- Të kërkojë me më shumë forcë e vendosmëri nga organet e ndjekjes penale procedimin rezultativ të zyrtarëve të zbuluar prej tij në konflikt interesi apo në fshehje të pasurive të tyre;

- Të informojë publikisht ose drejtpërdrejt Kuvendin për rastet kur autoritetet përgjegjëse, respektivisht Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë apo Ministria e Drejtësisë neglizhojnë ose kapin rezultate të ulëta në ndjekjen dhe ndëshkimin e konfliktit të interesit apo fshehjes së pasurisë të zbuluar prej tij;

- Të forcojë instrumentet e investigimit administrativ, sidomos në sektorë të jetës publike, ku fenomeni i korrupsionit është më i përhapur dhe besimi i publikut më i ulët;

- Të vijojë forcimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes ndaj shoqërisë civile, medias dhe publikut të gjerë për informacionet e dhëna për rastet e denoncimit të shkeljes së ligjit për deklarimin e interesave privatë pasurorë, si dhe për rastet e identifikimit të konfliktit të interesave.

29 prill 2010

DEKRET

Nr.6525, datë 29.4.2010

PËR LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Gabriel Sokol Alia
2. Adelina Enver Bejtaga (Kurti)
3. Megi Agim Bejtaga
4. Anila Gazmend Pusta (Llazani)
5. Ervin Perikli Papa
6. Artur Arif Muskollari
7. Altin Agron Satko
8. Helidon Eduart Dollani
9. Alda Sulo Dollani (Brahimaj)
10. Julia Helidon Dollani
11. Erdita Fadil Cakaj (Çokaj)
12. Jani Kristo Patos
13. Valbona Agron Lamaj (Leissle)

14. Bukurije Idriz Schwarz (Zyberi)
15. Albana Lekë Gjinaj (Goraj)
16. Ardi Caci Kuqi
17. Lefter Xhevdet Lata
18. Nevlja Sejfi Kalanxhi (Agastra)
19. Jon Altin Kalanxhi
20. Endri Ali Cara
21. Velo Zhivo Vuçiq (Vuçiq)
22. Bose Kolo Vuçiq (Nikollaj)
23. Dragana Velo Vuçiq (Vuçiq)
24. Ariana Nazmi Likja (Allushi)
25. Marcelo Kostandin Likja
26. Luciano Kostandin Likja
27. Perparim Abdyl Wenkel (Ceku)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.274, datë 13.4.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në pjesën I të vendimit nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në kreun I titulli II, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Në nenin 3 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:
 - i) Organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nga 1062 punonjës bëhet 991 punonjës, të shpërndarë në nivel qendror dhe vendor.
 - ii) Lidhja 1 “Struktura organike” ekzistuese, zëvendësohet me lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 - b) Pas shkronjës “f” të pikës 3.1 të nenit 3, shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje: “g. Kategoria D3- personel sanitar.”.
 - c) Në pikën 3.2 të nenit 3, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:
 - i) Në shkronjën “c”, pas emërimit “... kryetar i degës së doganës, Shkodër...” shtohen emërtimet “... kryetar i degës së doganës Rinas...” dhe “...kryetar i degës së doganës, Porto Romano...”.
 - ii) Në shkronjën “ç” emërtesa “... përgjegjës sektori në drejtorinë rajonale...” shfuqizohet.
 - iii) Në shkronjën “d”, pas emërimit “... specialist në Drejtorinë e Përgjithshme...” shtohen emërtimet “...auditues...” dhe “...komandant grupi...”.
 - iv) Në shkronjën “e”, pas emërimit “...shoqërues...” shtohet emërtimi “...ndërlidhës...”.

v) Në shkronjën “f” fjalët “... që kryen shërbime sanitare dhe të mirëmbajtjes së zyrave...”, zëvendësohen me “... që kryen shërbime të mirëmbajtjes së zyrave...”.

vi) Pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje:

“g. Kategoria D3. Personeli që kryen shërbime sanitare.”.

ç) Në pikën 4.1 të nenit 4 bëhen këto ndryshime:

i) Në shkronjën “b” emërtesa “...sektori i trajnimit... zëvendësohet me “...sektori i trajnimit dhe etikës...”;

ii) Shkronja “c” shfuqizohet.

d) Në pikën 4.2 të nenit 4, emërtesa “...Drejtoria e Kompjuterizimit...”, zëvendësohet me “...Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit...”.

dh) Në pikën 4.4 të nenit 4, bëhen këto ndryshime:

i) Në shkronjën “a”, emërtesa “... sektori i investimeve...” zëvendësohet me “...sektori i investimeve dhe logjistikës...”.

ii) Shkronja “b” shfuqizohet.

e) Pika 5.1 e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.1. Drejtoria e Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore përbëhet nga:

a) sektori i procedurave;

b) sektori i kontrollit të pagesave dhe garancive doganore.

Kjo drejtori administron procedurat doganore dhe lëshimin e autorizimeve për to, si dhe për agjentët doganorë. Kjo drejtori, në përputhje me dispozitat në fuqi,

i) administron dokumentacionin për lëvizjen e mallrave dhe të bagazheve brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, deklaratat përmbledhëse, dokumentet për magazinimin e përkohshëm të mallrave dhe për deklarimin doganor;

ii) administron dokumentet për turizmin ndërkombëtar, procedurat e vendosjes në qarkullim të lirë dhe të eksportit, procedurat e tranzitit, të përpunimit aktiv dhe pasiv, të përpunimit nën kontroll doganor, të lejimit të përkohshëm, procedurat e magazinimit doganor, zonat e lira dhe magazinat e lira;

iii) administron dokumentet për magazinat e furnizimit dhe “Duty Free Shops”, furnizimet dhe pajisjet për përdorim në bord të mjeteve të transportit, për ndalimet dhe kufizimet në importin dhe eksportin e mallrave me karakter fito-sanitar;

iv) administron rregullat, si dhe procedurat e dhënies së garancisë, të monitorimit dhe të zhbllokimit të tyre;

v) kontrollon dhe monitoron të gjitha pagesat në sistem, përgatitjen e procedurave të kreditimit të pagesave dhe të kontrollit të tyre me bankat e thesarin;

vi) përgatit raportime periodike 1 (një)-muajore, për kreditë dhe debitë e trashëguara për shkak të veprimtarisë doganore;

vii) jep udhëzimet e nevojshme për përdoruesit në lidhje me sistemet e të dhënave, të formularëve, të regjistrave dhe të blloqeve përkatëse, të nevojshme në lidhje me procedurat doganore.”.

ë) Pika 5.2 e nenit 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.2 Drejtoria e Origjinës dhe Tarifës, Akcizës dhe TVSH-së përbëhet nga:

a) sektori i tarifës, akcizës, TVSH-së;

b) sektori i origjinës.

Kjo drejtori harton dhe përditëson nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore, si dhe administron shënimet (notat) shpjeguese, jep informacion tarifar të detyrueshëm (ITD), administron operacionet e privileguara, mbikëqyr rregullat për akcizën, TVSH-në dhe taksat e tjera në import. Gjithashtu, kjo drejtori administron origjinën e mallrave, sipas marrëveshjeve preferenciale përkatëse, procedurat e lëshimit të certifikatave të origjinës preferenciale, ndjek zbatimin e masave të politikës tregtare, të kuotave dhe të tavaneve tarifore dhe të masave antidumping.”.

f) Pika 5.4 e nenit 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.4 Drejtoria e Statistikës ka për detyrë mbledhjen e të dhënave për lëvizjen e mallrave shqiptare dhe joshqiptare, që hyjnë e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, analizimin e të dhënave, objekt të vlerësimit nga zyrat e interesura dhe autoritetet publike, në përputhje me legjisllacionin në fuqi.”.

g) Pika 6.1 e nenit 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6.1 Drejtoria e Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit përbëhet nga:

a) sektori i antikontrabandës tokësore;

- b) sektori i antikontrabandës detare;
- c) sektori i rikuperimit me forcë të borxhit.

Kjo drejtori kryen kontrolle fizike dhe dokumentare, në bazë të të dhënave dhe analizës së riskut, në çdo vend, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke kontrolluar apo shqyrtuar mallrat, personat dhe mjetet e transportit, me qëllim zbulimin dhe frenimin e kontrabandës dhe të kundërvajtësve administrativë, brenda territorit doganor shqiptar, dhe nga/apo drejt territorit të vendeve të tjera. Nëpërmjet kryerjes së kontrolleve, identifikon dhe jep të dhëna rreth veprimtarisë ose personave të dyshimtë për data base-in e informacionit, jep ndihmë në hetimin e shkeljeve doganore. Gjithashtu, kjo drejtori administron procedurat për lindjen e rikuperimit e borxhit doganor, përgatit dhe administron udhëzimet për kontabilizimin e të ardhurave nga detyrimet e importit ose të eksportit, për vjeljen e detyrimeve dhe për rimbursimin ose shlyerjen e borxhit doganor, si dhe administron procedurat për rikuperimin dhe vjeljen me forcë të borxhit doganor.”.

gj) Pika 6.2 e nenit 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6.2 Drejtoria e Hetimit përbëhet nga sektori i hetimit të shkeljeve doganore.

Kjo drejtori ndërmerr hetime për shkelje të dyshuara apo të vërejtura nga grupet e antikontrabandës, të drejtorisë së informacionit, si dhe të strukturave të tjera, me kërkesë të tyre apo me nismën e vet, brenda dhe jashtë sistemit doganor. Gjithashtu, kjo drejtori mbledh të dhëna, përgatit kallëzime penale për në organin e prokurorisë, harton raporte dhe praktika në ndihmë të këtij organi.”.

h) Pas pikës 6.5 të nenit 6, shtohen pikat 6.6 e 6.7, me këtë përmbajtje:

“6.6 Drejtoria Antitrafik përbëhet nga:

- a) sektori i luftës kundër trafikut të armëve, lëndëve radioaktive dhe kontrollit të mallrave të përdorimit të dyfishtë dhe i mbrojtjes së mjedisit;
- b) sektori i luftës kundër trafikut të drogave dhe lëndëve të tjera;
- c) sektori i luftës kundër trafikut të automjeteve e veprave të artit;
- ç) sektori i parandalimit të pastrimit të parave.

Drejtoria Antitrafik ka si objekt të veprimtarisë së saj zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, veçanërisht në funksion të përmbushjes së misionit mbrojtës për sigurinë kombëtare dhe rendin publik. Veprimtaria e Drejtorisë Antitrafik lidhet me organizimin e mbikëqyrjes së kufirit shtetëror nga strukturat e shërbimit doganor që operojnë në kufi, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve të mallrave, të mjeteve të transportit dhe të subjekteve, për parandalimin e trafikeve të paligjshme, përfshirë parandalimin e pastrimit të parave, kontrollit të transferimit fizik të valutës, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit. Drejtoria Antitrafik mund të shkëmbejë të dhëna me struktura të tjera doganore apo shtetërore, me kompetenca në fushën e zbatimit të ligjit, mbi mallra, mjete apo subjekte, me qëllim parandalimin dhe goditjen e shkeljeve të parashikuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi kundër trafikeve. Ajo bashkëpunon me agjenci, institucione dhe aktorë të tjerë, përfshirë ata ndërkombëtarë, të cilët kanë detyrime ligjore ose që janë të angazhuar në luftën kundër trafikeve.

6.7. Drejtoria për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale ka për detyrë, mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (pronësinë industriale dhe pronësinë intelektuale) për mallrat që hyjnë në/ose dalin nga territori shqiptar, me kërkesë të mbajtësve të së drejtës ose “ex office”, administrimin e kërkesave për veprim në kuadër të mbrojtjes së pronësisë intelektuale.”.

i) Në pikën 7.1 të nenit 7, emërtimi “...Drejtoria e Kontrollit të Brendshëm...” zëvendësohet me “...Drejtoria e Auditimit të Brendshëm...” dhe emërtesa e sektorëve në përbërje të saj ndryshohet si më poshtë vijon:

- “a) Sektori i auditit financiar;
- b) Sektori i auditit operacional.”.

2. Në kreun II “Organizimi dhe përgjegjësitë e administratës doganore lokale”, titulli II, në nenin 9, pas fjalëve “...Tri Urat...” shtohen “...Porto Romano...”.

3. Në kreun III “Klasifikimi, rekrutimi, përgjegjësitë dhe vlerësimi i personelit”, titulli II, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën b.1 të nenit 11, pas fjalëve “...Drejtoria e Administrimit të Personelit dhe e Trajnimit...” shtohen “...pas miratimit të komisionit të përzgjedhjes së kandidatëve...”.

b) Në fund të pikës b.2 të nenit 11, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Komisioni me shumicën e anëtarëve miraton rregulloren e funksionimit të tij, si dhe rregullat për organizimin e konkursit.”.

c) Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

i) Pika 11.10.2 shfuqizohet;

ii) Pas pikës 11.10.7 shtohen pikat 11.10.8 e 11.10.9, me këtë përmbajtje:

“11.10.8. Në raste specifike, për nevoja pune dhe me miratim të Ministrit të Financave, kriteri për përvojat e mëparshme në punë, sipas përcaktimeve përkatëse për pozicion, parashikuar në nenin 11, pikat 11.7.1, shkronja “a”, dhe 11.8. shkronja “a”, si dhe në aneksin 1, të dispozitave zbatuese, mund të mos zbatohet.

11.10.9. Në procedurat e rekrutimit dhe të ngritjes në kategori për të gjitha kategoritë e punonjësve të teknologjisë së informacionit, në nivel qendror, rajonal apo vendor, nuk zbatohen kriteret dhe përcaktimet e pikave 11.1 – 11.10.4 të nenit 11, dhe të aneksit 1. Rregullat për punësimin dhe ngritjen në kategori të këtyre punonjësve përcaktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Në rast se punonjësit e teknologjisë së informacionit, në nivel qendror, rajonal apo vendor, të çdo kategorie, ndryshojnë funksion në administratën doganore, procedura e rekrutimit të tyre të jetë sipas nenit 11 dhe aneksit nr.1, njëjloj si për të gjitha funksionet e tjera të administratës.”.

ç) Pas nenit 12 shtohet neni 13, me këtë përmbajtje:

“Neni 13

Pezullimi

1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve ligjore të punës për periudhën sa zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në mbarim të kësaj periudhe, punonjësi rimerr vendin e tij, me përjashtim të rasteve kur dënohet me heqje lirie apo largohet për shkelje nga administrata doganore.

2. Punonjësi i administratës doganore pezullohet kur:

a) ndaj tij fillon ndjekja penale për shkak të detyrës ose për krime të rënda, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar;

b) eprori direkt apo strukturat eprorë kanë konstatuar shkelje të kryera nga punonjësi. Në këtë rast, pezullimi zgjat për aq kohë, sa rasti të shqyrtohet në komitetin disiplinor dhe të jetë marrë vendimi përfundimtar nga Drejtori i Përgjithshëm.

3. Gjatë periudhës së pezullimit punonjësi nuk paguhet. Në rastet e parashikuara në shkronjën “a” të pikës 2, kur çështja penale pushohet ose kur me vendim gjykate të formës së prerë deklarohet i pafajshëm dhe/ose në rastet e parashikuara në shkronjën “b” të pikës 2, kur me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm punonjësi nuk largohet nga administrata doganore, punonjësit i jepet paga që nga çasti i pezullimit.

4. Periudha e kohës së pezullimit nga detyra merret në konsideratë për llogaritjen e vjetërsisë në punë.”.

4. Pas pikës 2 të nenit 52, titulli 5 “Origjina e mallrave”, kreu II “Origjina preferenciale”, të shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Në rastet kur pas verifikimit tek autoritetet doganore të vendit eksportues rezulton se certifikata e origjinës preferenciale EUR 1 është autentike, e vulosur nga autoritetet doganore të vendit eksportues, por malli i eksportuar drejt Shqipërisë nuk plotëson kushtet për përfitimin e origjinës preferenciale, subjekti importues depozitues i EUR 1 pranë autoriteteve doganore shqiptare, paguan shumën e plotë të detyrimeve doganore që duheshin paguar në kushtet e mungesës së preferencës ndaj origjinës, si dhe kamatëvonesat përkatëse, pa iu nënshtruar sanksioneve të tjera të aplikueshme.”.

II. Në aneksin 13 “Kode për t’u përdorur në formularë”, të dispozitave zbatuese në shpjegimet për kutinë 37 “Regjimet nën import/eksportet”, të deklaratës doganore, në listën e regjimeve për qëllime kodimi bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Regjimi 71 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“71: Regjimi i magazinimit doganor, përfshirë furnizime për magazinat e furnizimit, furnizime për dyqanet duty free, si dhe vendosjen në mjedise të tjera nën kontrollin doganor.”.

b) Regjimet 95 e 96 shfuqizohen.

III. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Struktura organike e administratës doganore

Lidhja nr.1

Emertimi i postit		Kodi Zyres		Kateg	Nr. Puno njësve	Kategoria e Pagës
Kabineti Drejtorit	Kabineti Drejtorit	1000	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	II-a
			Keshilltar i Përgjithshëm	A	2	III-a
			Sekretare	C3	1	
			Përgjegjës Sektori Shtypit	B	1	III-a/1
					5	
Drejtoria Marrëdhënies me Jashtë	Drejtoria Marrëdhënies me Jashtë	1400	Drejtor Marrëdhënies me Jashtë	A	1	III-a
			Specialist i marrëdhënies ndërkombetare	C1	1	III-b
			Perkthyes	C1	1	III-b
					3	
Drejtoria Auditimit Brendshëm		1500	Drejtor Auditit Brendshëm	A	1	III-a
	Sektor i Auditit financiar	1510	Përgjegjës Auditit Financiar	B	1	III-a/1
			Auditues financiar	C1	2	III-b
	Sektor i Auditit Operacional	1520	Përgjegjës Sektori Auditit Operacional	B	1	III-a/1
			Auditues Operacional	C1	5	III-b
					10	
			Totali Kabinetit		18	
Departamenti Teknik		1200	Zv/Drejtor Përgjithshëm Teknik		1	II-b
			Sekretare	C3	1	
					2	
Drejtoria Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore		1210	Drejtor Procedurave, Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore	A	1	III-a
	Sektor i procedurave	1211	Përgjegjës sektori	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	4	III-b
	Sektor i Kontrollit të Pagesave dhe Garancive Doganore	1212	Përgjegjës sektori	B	1	III-b
			Specialist	C1	2	III-b
					9	
Drejtoria Origjinës, Tarifes Akcizes dhe TVSH-se		1220	Drejtor Origjinës, Vleres, Tarifes	A	1	III-a
	Sektor i Tarifes/Akcizes/TVSH-se	1221	Përgjegjës sektori tarifës/akcize,TVSH	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	3	III-b
	Sektor Origjinës	1222	Përgjegjës Sektori origjinës	B	1	III-a/1

			Specialist	C1	3	III-b
					9	
Drejtoria Vleres Doganore			Drejtör Vleres Doganore	A	1	III-a
	Sektori Mbikqyerjes se Vlerës Doganore	1224	Pergjegjes Sektori Mbikqyerjes Vleres	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	3	III-b
	Sektori për referencat		Pergjegjes sektori per referencat	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	3	III-b
					9	
		1230	Drejtör Juridik	A	1	III-a
Drejtoria Juridike		1230	Sekretare	C3	1	
	Sektori legjislacionit dhe perafimit BE	1231	Pergjegjes Sektorit të legjislacionit dhe perafimit BE	B	1	III-a/1
			Specialist legjislacioni	C1	2	III-b
	Sektori i ankimimeve	1232	Pergjegjes sektori ankimimeve	B	1	III-a/1
			Specialist jurist	C1	4	III-b
					10	
Drejtoria e Statistikave						
		1240	Drejtör Statistike	A	1	III-a
		1241	Specialiste	C1	5	III-b
					6	
Drejtoria e Laboratorit Kimik Doganor		1250	Drejtör Laboratorit Kimik Doganor	A	1	III-a
			Sanitar	D3	1	
	Sektori standarteve, metodikave dhe administrimit	1251	Pergjegjes Sektori standarteve dhe metodikave dhe Administrimit	B	1	III-a/1
			Specialist laborante	C1	2	III-b
			Sekretare	C3	1	
	Shef sektori analizave	1252	Pergjegjes Sektori analizave	B	1	III-a/1
			Specialist laborante	C1	6	III-b
			Asistentë laborante	C2	6	IV-a
					19	
			Totali Departamentit Teknik		64	
Departamenti Operativ Hetimor		1300	Zv/Drejtör Pergjithshem Operativ Hetimor	II-b	1	II-b
			Sekretare	C3	1	
					2	
Drejtoria		1320	Drejtör Antikontrabandes	A	1	III-a
	Sektori Antikontrabandes Tokesore	1321	Pergjegjes Sektori Antikontrabandes Tokesore	B	1	III-a/1
			Komandante grupi antikondrabande	C1	15	III-b
Antikontrabandes dhe Rikuperimit me Force te Borxhit			Inspektor antikontrabande	C2	36	IV-a
	Sektori Antikontrabandes Detare	1322	Pergjegjes Sektori Antikontrabandes Detare	B	1	III-a/1
			Komandant motovedete	C1	5	III-b

			Specialist Logjistike (Inxhinjer)	C1	1	III-b
			Specialist Qendres Nderinstitucionale Operacionale Detare	C1	5	III-b
			Inspektor i antikondrabandes detare	C2	15	IV-a
			Magazinjer	D1	1	
			Teknik marine/motorist	D1	5	
	Sektori Rikuperimit me Force te Borxhit		Pergjegjes Sektori Rikuperimit te Borxhit	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	2	III-b
					89	
Drejtoria			Drejtore Antitrafik	A	1	III-a
Antitrafik	Sektori luftes kunder armeve konvencionale dhe demtimit ne mase		Pergjegjes Sektori Luftes kunder armeve konvencionale dhe demtimit ne mase	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	2	III-b
	Sektori luftes Kunder drogave dhe lendeve te tjera		Pergjegjes Sektori luftes Kunder drogave dhe lendeve te tjera Shef Sektori	B	1	III-a/1
		1370	Specialiste	C1	2	III-b
	Sektori luftes Kunder trafikut te automjeteve dhe veprave te artit		Pergjegjes Sektori luftes Kunder trafikut te automjeteve dhe veprave te artit	B	1	III-a/1
			Specialist	C1	2	III-b
	Sektori luftes Kunder parandalimit dhe pastrimit te parave		Pergjegjes Sektori luftes Kunder parandalimit dhe pastrimit te parave	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	2	III-b
					13	
		1330	Drejtore Hetimi	A	1	III-a
			Sekretare	C3	1	
Drejtoria e Hetimit	Sektori Hetimit te shkeljeve Doganore	1331	Pergjegjes Sektori Hetimi te Shkeljeve Doganore	B	1	III-a/1
			Specialist Hetues	C1	14	III-b
		1332	Oficer Policise Gjyqesore		8	
					25	
		1380	Drejtoria per mbrojtjen e Pronesise Intelektuale	A	1	III-a
Drejtoria per mbrojtjen e Pronesise Intelektuale			Specialiste	C1	3	III-b
					4	
Drejtoria e Kontrolleve paszhdoganimit (aposteriori)		1340	Drejtore Kontrolleve Paszhdoganimeve (Aposteriori)	A	1	III-a
	Sektori kontrollit Vleres/klasifikimit/origjines	1341	Pergjegjes Sektori kontrollit Vleres/klasifikimit/origjines	B	1	III-a/1

			Specialiste	C1	4	III-b
	Sektori kontrollit te rregjimeve doganore	1342	Pergjegjes Sektori kontrollit te rregjimeve doganore	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	4	
					11	
Drejtoria e Informacionit		1350	Drejtor Informacionit	A	1	III-a
		1351	Perfaqesuese ne SECI	A	1	III-a
			Sekretare	C3	1	
	Sektori Inteligjences Operative		Pergjegjes Sektori Inteligjences Operative	B	1	III-a/1
			Specialiste te inteligjencës operative	C1	9	III-b
	Sektori analizes riskut	1353	Pergjegjes Sektori analiza riskut	B	1	III-a/1
			Specialist i analizës riskut	C1	6	III-b
			Specialiste Analizes Riskut (skanerat)	C1	1	III-b
			Specialist IT suport	C1	1	III-b
	Sektori Shkembimit Informacionit	1354	Pergjegjes Sektori Shkembimit Informacionit	B	1	III-a/1
			Specialiste	C1	6	III-b
					29	
Qendra Operative		1360	Drejtor i Qendres Operative	A	1	III-a
			Pergjegjes Turni	C1	4	III-b
			Inspektor	C2	4	IV-a
			Perpunues Informacioni	C3	4	
					13	
			Totali Departamentit Operativ Hetimor		186	
Departamenti Administrativ		1100	Zv/Drejtor Pergjithshem Administrativ	II-b	1	II-b
			Sekretare	C3	1	
					2	
